



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

## **RAPORT I VITIT 2021 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

### **1. Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë vitit 2021 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka realizuar konsultime publike për projektat në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i cili përcakton procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare.

Vlerësohet se procesi i konsultimit publik në raport me vitin 2020, ka patur përmirësime të dukshme ku projekt aktet e publikuara në Regjistrin Elektronik gjatë vitit 2021, janë shoqëruar me planin e konsultimit publik, si edhe me dokumentin konsultativ të procesit të konsultimit publik, duke publikuar një paketë të plotë dhe të qartë për komentuesit dhe vizitorët e faqes zyrtare, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka publikuar pas procesit të konsultimit publik të projekt-akteve si më poshtë detajuar, edhe raportet përkatëse individuale për rezultatet e konsultimit publik<sup>1</sup> për secilin projekt akt të publikuar në Regjistrin Elektronik, duke specifikuar dhe bërë transparente: Kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike në 20 ditë pune; Metodën e konsultimit të përdorur, të tilla si: konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, Takimet publike, Takimet online etj; Palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit si edhe pasqyrën e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar apo refuzuara.

Përmirësimet në këtë proces janë tregues i zhvillimit të një qasje të integruar për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike për projektaktet dhe politikat e MFE, si një hap thelbësor për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies. Krahasur me vitin 2020, numri i përgjithshëm i projekt akteve që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik përmes jo vetëm Regjistrin Elektronik por dhe metodave të tjera të konsultimit publik, është rritur në **12 projektakte**.

<sup>1</sup><https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/4>

Vihet re përmirësim i dukshëm nga MFE lidhur me palët e interesit të përfshira, krahasuar me vitin 2020.me **përfshirje të gjërë nga:** përfaqësues të institucioneve akademike, përfaqësues të Shoqatave të Biznesit; Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, IFC, BERZH, EU); Ministrinë e Linjës AKKSHI, AIDA, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore etj.

Gjithashtu një tendencë në rritje dhe një përmirësim të dukshëm, krahasuar me vitin 2020, vihet re sa i takon komenteve të marra, duke kapur maksimumin në 89 komente për vetëm një projektligj nga aktorë të ndryshëm. Vihet re dhe është për t'u vlerësuar fakti se se tek komentet e refuzuara ose të pranuar pjesërisht për secilin projektligj, paraqitet edhe arsyetimi i refuzimit në raportet individuale në formë të përmbledhur tabelore, pas konsultimit të projektakteve si mëposhtë.

## 2. Analiza e konsultimeve të kryera


### 2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

#### 2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Në total gjatë vitit 2021 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë miratuar **187 akte**.

#### 2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

17 projekt akte kanë qenë objekt konsultimi. Prej tyre 5 akte janë konsultuar nëpërmjet Regjistrimit Elektronik dhe 6 akte janë konsultuar me metoda të tjera. 6 akte për arsye specifike nuk janë konsultuar.



17 akte objekt i konsultimit publik janë:

1. VKM nr.7, datë 13.01.2021 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal, për periudhën 2022-2024”;
2. VKM nr.37, datë 27.1.2021 “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023”;
3. VKM nr.38, datë 27.1.2021 “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2021-2023”;

4. VKM nr.136, datë 10.3.2021 “P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”;
5. VKM nr.284, datë 14.5.2021 “P-Ligj për një ndryshim në ligjin 10081/2009, për licencat, autorizimet dhe lejet në RSh të ndryshuar;
6. VKM nr. 442 “Për miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2022 – 2024”;
7. VKM nr. 466 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”;
- 8.VKM nr. 522 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9917, date 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
9. VKM nr.638 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
10. VKM nr.639 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
11. VKMnr. 641 “Për disa shtesa në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar;
12. VKM nr.641 “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;
13. VKM “Për miratimin e Projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 –2024;
14. VKM 763 Projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme;
- 15.VKM nr.765 Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.112/2020 “Për Regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar;
- 16 VKM nr. 834Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.02.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.03.1995, “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.02.1995”;
17. VKM nr. 764 Për një ndryshim në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar.

Aktet për të cilat janë zhvilluar konsultime publike edhe duke u publikuar në RENJK, duke përmbushur parakushtin për vlerësim të procesit të konsultimit publik janë:

1. “P-Ligji për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”;
2. VKM nr. 466 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”;
3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9917, date 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
4. Projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme;
5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.112/2020 “Për Regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

**4 ligje** me Raport VNR-je janë konsultuar, përkatësisht si vijon:

VKM nr.136, datë 10.3.2021 P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”; është konsultuar me raport VNR-je;

VKM nr. 522 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9917, date 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

Projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme;

VKM nr. 466 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga procesi i konsultimit publik janë përfjashtuar në total 23 projektakte të planifikuara në Planin e Përgjithshëm Analitik për vitin 2021 për MFE dhe 17 projekt akte të planifikuara ne Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe dokumenta strategjike.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Janë konsultuar përmes RENJK 1 (një) dokument strategjik si edhe 4 (katër) p/ligje.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata në krahasim me vitin 2020, ka përmirësime, tregues ky i zhvillimit i një qasjeje të integruar për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike për projektaktet dhe politikat e MFE si një hap thelbësor për përmirësimin e transparencës e zhvillimit. Krahasur me vitin 2020, numri i përgjithshëm i p.akteve që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik përmes jo vetëm Regjistrisë Elektronike por dhe metodave të tjera të konsultimit publik, është 12.

## **2.2. Metodatat e konsultimit**

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

**1.Takime me grupet e interes:** takime onlinepër shkak të respektimit të masave lidhur me situatën e COVID-19 por edhe takime fizike, me përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe akademisë, donatorët në 2 raste në nivel kryesimi të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.Njoftimet janë shpërndarë në rrugë elektronike si me email, ashtu edhe në faqen zyrtare të rrjeteve sociale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. (12 akte);

2. **Mbledhje e mendimeve dhe sugjerimeve nëpërmjet postës elektronike**, si edhe **shkresave** (12 akte);
3. **Takime konsultuese me aktorë të ndryshëm**;
4. **Publikimi në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike** në linkun si edhe njoftuar në faqen zyrtare të rrjeteve sociale të MFE-së (5 akte).

#### 2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Për shkak edhe të situatës së krijuar nga pandemia shkaktuar nga COVID-19, numrin më të madh të komenteve e gjeneroi posta elektronike dhe takimet online dhe fizike lidhur me strategjinë BIDS ku janë dhënë gjithësej **89 komente dhe sugjerime**. Nga këto: **9 komente/rekomandime janë nuk janë pranuar; 10 komente janë pranuar pjesërisht dhe 70 komente/rekomandime,, janë pranuar.**

#### 2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Njoftojmë se kjo pikë nuk është e aplikueshme për MFE, për vitin 2021.

### 2.3. **Kohëzgjatja e konsultimeve**

#### 2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

1. P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”. Kohëzgjatja e konsultimit publik përmes regjistrin elektronik zgjati nga data 27.11.2020 deri 27.12.2020, konkretisht në linkun: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/303>.
2. *Projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit Ministria e Financave dhe Ekonomisë në periudhën 26 Maj – 2 Korrik ka publikuar projektaktin për konsultim publik si nëpërmjet RENJK në linkun <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/351>; postës elektronike, takimeve online ashtu edhe atyre fizike ku janë organizuar në datat 3 dhe 21-23 qershor takimet me aktorë të ndryshëm përfshirë donatorët, bizneset dhe shoqatat e biznesit si edhe përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë publike dhe private.*
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar Projektligji është hedhur nga MFE në platformën online të konsultimit publik në datë 22.01.2021. Takimi i parë online u zhvillua në datë 23.02.2021. Konsultimi mbi projektligjin, me subjektet që i nënshtrohen ligjit si dhe me Institucione publike është realizuar për periudhën Janar 2021- Maj 2021 Konsultimi aksesohet në linkun <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/321>
4. Projektligj “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” Kohëzgjatja e konsultimeve publike ka qenë nga muaji qershor-korrik 2021 ku përmes Regjistrin Elektronik në RENJK është realizuar nga data 07.6.2021-07.7.2021 *Publikimi aksesohet në linkun <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/355>, si edhe njoftuar në faqen zyrtare të rrjeteve sociale të MFE-së:*

5. Kohëzgjatja e konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike për projekt ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", i ndryshuar , u krye në periudhën 02.12.2021 deri më 02.01.2022 Konsultimi aksesohet në linkun <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/436>

### 2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Për aktet e sipërcituara kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qënë 1 muaj (20-21 ditë pune).

### 2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata në vitin 2021, ka pasur përmirësime të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik ka qënë më i lartë. Gjithashtu janë njoftuar link-s të publikimeve të paketave të plota për secilin p.akt të konsultuar, ku njoftohej edhe data e hapjes apo e mbylljes së konsultimeve publike.

## 2.4. Palët e interesuara të përfshira

### 2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Sa i takon Projektvendimi "Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit" aktorët e jashtëm joqeveritarë që morën pjesë në konsultim, paraqiten si mëposhtë:

- Përfaqësues të institucioneve akademike: **16 pjesëmarrës** (Universiteti i Tiranës, Universiteti Mesdhetar, Universiteti A.Moisiu, UET, Epoka, UBT etj)
- Përfaqësues të Shoqatave të Biznesit: 15 pjesëmarrës (Dhoma e Tiranës, CCI, Unioni i Dhomave, Konfindustria, Amcham, Dhoma Greke etj)
- Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, IFC, BERZH, EU)

Sa i takon projektligjit "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" Në këtë proces raportohen: Përfaqësues të Akademisë dhe Shoqërisë Civile (Universiteti i Tiranës, UET, UBT, EPOKA, Universiteti Mesdhetar etj) **13 pjesëmarrës**; Shoqatat e Biznesit (Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë, Dhoma Gjermane, UCCIAL, Dhoma e Tiranës, Nordic Association etj) 16 pjesëmarrës; Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, EBRD, UN)Institucione të tjera (Këshilli i Investimeve)

Sa i takon projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" raportohen: Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë (Credins Bank, OTP BANK, Banka Tirana, Alpha Bank Albania (ABA), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Raiffeisen Bank, Procredit-Group, Union Bank, Fibank, Intesa Sanpaolo Bank, American Bank of Investment (ABI), United Bank of Albania (UBA)), institucioni financiar jobank (Ak-Invest), shoqëritë e transfertave (Union Financiar Tiranë (UFT) dhe Easypay), Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), IEKA, Posta Shqiptare, kompania e auditimit Deloitte Albania.

Gjithashtu komente mbi projektligjin kanë paraqitur edhe Eksperti ndërkombëtar e GIZ, Delegacioni i BE në Shqipëri.

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar ka dhënë mendim vetëm Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB).

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” morën pjesë Perfaqësues të Bashkimit të Dhomave të Tregtise dhe Industrise

*2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Sa i takon Projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit” struktura e palëve të interes të përfshira në konsultim, paraqiten si mëposhtë:

-Përfaqësues të institucioneve akademike -Përfaqësues të Shoqatave të Biznesit: Unioni i Dhomave, Konfindustria, Amcham, Dhoma Greke.

Sa i takon projektligjit “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” në këtë proces, raportohen Shoqata biznesi, publik i gjërë, donatorë, qeveri, institucione ndërkombëtare, Akademi si: Përfaqësues të Akademisë dhe Shoqerisë Civile.

Sa i takon projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar raportohen: Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë (Credins Bank, OTP BANK, Banka Tirana, Alpha Bank Albania (ABA), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Raiffeisen Bank, Procredit-Group, Union Bank, Fibank, Intesa Sanpaolo Bank, American Bank of Investment (ABI), United Bank of Albania (UBA)), institucioni financiar jobank (Ak-Invest), shoqëritë e transfertave (Union Financiar Tiranë (UFT) dhe Easypay), Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), IEKA, Posta Shqiptare, kompania e auditimit Deloide Albania.

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar ka dhënë mendim vetëm Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, ka patur eksperte të jashtëm të kontraktuar nga KM për hartimin e RIA të projektligjit, përkatësisht raportohet Z. Kastriot Sulka.

*2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Në konsultimet publike të hapura për vitin 2021 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, morën pjesë dhe dhanë komente e sugjerime mbi 80 (tetëdhjetë) palë të interesuara, me të dhënat si mëposhtë vijon:

Sa i takon Projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit” palët e interesit si mëposhtë dhanë kontribute:

-Përfaqësues të institucioneve akademike: -Përfaqësues të Shoqatave të Biznesit (Dhoma e Tiranës, CCI, Unioni i Dhomave, Konfindustria, Amcham, Dhoma Greke etj); Institucione ndërkombëtare (Banka Boterore, IFC, BERZH, EU)Ministritë e Linjës (MEPJ, MD, MASR, Minister Shteti për

Diasporën, MIE, MTM, MBZHR, Min.Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes); Institucione të tjera (AKKSHI,AIDA, Agjencia per Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, KM)

Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore, nëpunësit e nxitjes së biznesit në MFE si edhe përfaqësues të Akademisë dhe Organizatave të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare

Sa i takon projektligjit “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” Në këtë proces raportohen 6 palë të përfshira: Shoqata biznesi, publik i gjërë, donatorë, qeveri, institucione ndërkombëtare, Akademi si: Përfaqësues të Akademisë dhe Shoqërisë Civile (Universiteti i Tiranës, UET, UBT, EPOKA, Universiteti Mesdhetar etj) 13 pjesëmarrës; Shoqatat e Biznesit (Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë, Dhoma Gjermane, UCCIAL, Dhoma e Tiranës, Nordic Association etj) 16 pjesëmarrës; Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, EBRD, UN)Ministritë e Linjës (MEPJ, MD, MASR, Minister Shteti për Diasporën, MIE etj ).Institucione të tjera (Këshilli i Investimeve)Më konkretisht:Projektakti u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë për Mbështetjen e Sipërmarrjes, Ministrinë e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësinë e Vetqeverisjes Vendore.Unioni i Dhomave gjithashtu ka qënë një nga palët e interes të përfshira në proces, bashkë me Shoqatat e Biznesit.Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore, nëpunëset/nëpunësit e nxitjes së biznesit në MFE si edhe përfaqësues të akademisë dhe organizatat kombëtare të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare si World Bank, EBRD, UN, pra 3 palë.

Sa i takon projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar subjektet të cilat kanë dhënë kontribut nëpërmjet komenteve të tyre, të cilët morën pjesë edhe në takimin online të organizuar nga DPPPP janë: Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë (Credins Bank, OTP BANK, Banka Tirana, Alpha Bank Albania (ABA), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Raiffeisen Bank, Procredit-Group, Union Bank, Fibank, Intesa Sanpaolo Bank, American Bank of Investment (ABI), United Bank of Albania (UBA)), institiuioni financiar jobank (Ak-Invest), shoqëritë e transfertave (Union Financiar Tiranë (UFT) dhe Easypay), Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), IEKA, Posta Shqiptare, kompania e auditimit Deloide Albania. Lidhur me strukturën e subjekteve të cilat morë pjesë në takim, ishin të organizuar nga 1 (një) përfaqësues për subjekt. Gjithashtu komente mbi projektligjin kanë paraqitur edhe Eksperti ndërkombëtar e GIZ, Delegacioni i BE në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Numri i pjesëmarrësve në konsultimin publik, në takim online të organizuar ashtu dhe nëpërmjet email ishte 28.

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar ka dhënë mendim vetëm Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)



Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare struktura e kontribuesëve përbëhet nga përfaqësues të Dhomave dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

*2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Sa i takon Projektvendimi “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimt” palët e interes të përfshira në konsultim paraqiten si mëposhtë:

-Përfaqësues të institucioneve akademike: 16 pjesëmarrës (Universiteti i Tiranës, Universiteti Mesdhetar, Universiteti A.Moisiu, UET, Epoka, UBT etj)

-Përfaqësues të Shoqatave të Biznesit: 15 pjesëmarrës (Dhoma e Tiranës, CCI, Unioni i Dhomave, Konfindustria, Amcham, Dhoma Greke etj)

-Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, IFC, BERZH, EU)

-Ministritë e Linjës (MEPJ, MD, MASR, Minister Shteti për Diasporën, MIE, MTM, MBZHR, Min.Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes).

-Institucione të tjera (AKKSHI,AIDA, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, KM)

Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore, nëpunësit e nxitjes së biznesit në MFE si edhe përfaqësues të Akademisë dhe Organizatave të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare

Sa i takon projektligjit “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” Në këtë proces raportohen 6 palë të përfshira: Shoqata biznesi, publik i gjërë, donatorë, qeveri, institucione ndërkombëtare, Akademi si: Përfaqësues të Akademisë dhe Shoqërisë Civile (Universiteti i Tiranës, UET, UBT, EPOKA, Universiteti Mesdhetar etj) 13 pjesëmarrës; Shoqatat e Biznesit (Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë, Dhoma Gjermane, UCCIAL, Dhoma e Tiranës, Nordic Association etj) 16 pjesëmarrës; Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, EBRD, UN) Ministritë e Linjës (MEPJ, MD, MASR, Minister Shteti për Diasporën, MIE etj ).Institucione të tjera (Këshilli i Investimeve)Më konkretisht:Projektakti u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë për Mbështetjen e Sipërmarrjes, Ministrinë e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore.Unioni i Dhomave gjithashtu ka qënë një nga palët e interes të përfshira në proces, bashkë me Shoqatat e Biznesit.Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore, nëpunëset/nëpunësit e nxitjes së biznesit në MFE si edhe përfaqësues të akademisë dhe organizatat kombëtare të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare si World Bank, EBRD, UN, pra 3 palë.

Sa i takon projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar subjektet të cilat kanë dhënë kontribut nëpërmjet komenteve të tyre, të cilët morën pjesë edhe në takimin online të organizuar nga DPPPP janë: Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë (Credins Bank, OTP BANK, Banka Tirana, Alpha Bank Albania (ABA), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Raiffeisen Bank, Procredit-

Group, Union Bank, Fibank, Intesa Sanpaolo Bank, American Bank of Investment (ABI), United Bank of Albania (UBA)), institucioni financiar jobank (Ak-Invest), shoqëritë e transfertave (Union Financiar Tiranë (UFT) dhe Easypay), Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), IEKA, Posta Shqiptare, kompania e auditimit Deloide Albania. Lidhur me strukturën e subjekteve të cilat morë pjesë në takim, ishin të organizuar nga 1 (një) përfaqësues për subjekt.

Gjithashtu komente mbi projektligjin kanë paraqitur edhe Eksperti ndërkombëtar e GIZ, Delegacioni i BE në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Numri i pjesëmarrësve në konsultimin publik, në takim online të organizuar ashtu dhe nëpërmjet email ishte 28.

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar ka dhënë mendim vetëm Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare struktura e kontribuesëve përbëhet nga përfaqësues të Dhomave dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

#### *2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vihet re përmirësim i dukshëm nga MFE lidhur me palët e interesit të përfshira, krahasuar me vitin 2020, ku si shembull vetëm për Projektvendimin “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”, janë dhënë gjithësej 89 komente dhe sugjerime. Gjithashtu vihet re përfshirje nga Përfaqësues të institucioneve akademike, Përfaqësues të Shoqatave të Biznesit; Institucione ndërkombëtare (Banka Boterore, IFC, BERZH, EU); Ministritë e Linjës (MEPJ, MD, MASR, Minister Shteti për Diasporën, MIE, MTM, MBZHR, Min.Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes), Institucione të tjera (AKKSHI, AIDA, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, KM). Rezulton se ka një rritje të theksuar si të aktorëve pjesëmarrës, ashtu edhe të kontribuesëve lidhur me p.aktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2021 nga MFE.

### **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

#### *2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithësej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Për Projektvendimin “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”, janë dhënë gjithësej 89 komente dhe sugjerime.

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, komentet në total të ardhura nga grupet e kontribuuese janë 44, 19 prej të cilave janë të pranuar plotësisht.


Për Projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, gjithësej janë dhënë 38 komente, nga të cilat 30 janë të reflektuara, 6 të reflektuara pjesërisht dhe 2 të refuzuara,

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar” janë dhënë gjithësej 9 komente, të cilat janë refuzuar.

Mbi P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore”, nuk ka patur asnjë koment.

#### 2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Numri total i komenteve të pranuar është 119 komente. Numri total i komenteve të pranuar pjesërisht është 16 komente dhe i atyre të refuzuara, është 40 komente.



Më poshtë paraqiten detajet për secilin projektligj:

Për Projektvendimin “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”, janë dhënë gjithësej 89 komente dhe sugjerime. Nga këto:9 komente/rekomandime janë nuk janë pranuar me arsyetimin e detajuar në raportin individual ;10 komente janë pranuar pjesërisht dhe70 komente/rekomandime të cilat janë adresuar nëpërmjet shtesave dhe riformulimeve në përshkrimin sipas masës përkatëse të Strategjisë në takimet e zhvilluara, janë pranuar.

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, komentet në total të ardhura nga grupet e kontribuuese janë 44, 19 prej të cilave janë të pranuar plotësisht.

Për Projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” gjithësej janë dhënë 38 komente, nga të cilat 30 janë te reflektuara, 6 të reflektuara pjesërisht dhe 2 te refuzuara,

Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar” janë dhënë gjithësej 9 komente, të cilat janë refuzuar.

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore”, nuk ka patur asnjë koment.

### *2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Vihet re një tendencë rritje dhe njëpërmirësim i dukshëm, krahasuar me vitin 2020, ku nr i komenteve të marra është rritur ndjeshëm, duke kapur maksimumin në 89 komente për një projektligj nga aktorë të ndryshëm. Gjithashtu vihet re dhe është për t’u vlerësuar fakti se se tek komentet e refuzuara ose të pranuar pjesërisht për secilin projektligj, paraqitet edhe arsytmi i refuzimit në raportet individuale në formë të përmbledhur tabelore, pas konsultimit të p.akteve më sipër.

### *2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

1 raport VNR-je: Për P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, VNR që shoqëron projektligjin, raportohet e përditësuar.

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### *2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2021, pas mbylljes së procesit të konsultimit publik sipas afatit referuar ligjit nr.46/2014 ka publikuar Raportet individuale për rezultatet e konsultimit publik<sup>2</sup> për secilin projekt akt të publikuar në Regjistër, përkatësisht për 4 p.akte të miratuara:

**VKM nr. 466 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”, publikuar në linkun:** <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/351>;

**Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9917, date 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, publikuar në linkun** <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/321>;

**Projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” publikuar në linkun** <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/355>;

**Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.112/2020 “Për Regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar, publikuar në linkun:** <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/436>.

### *2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk është publikuar për 1 projekt akt: as plani i konsultimit, as dokumenti konsultativ si edhe Raporti individual vetëm lidhur me p.ligjin e miratuar 6 mujorin e parë 2021, përkatësisht P-Ligji për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

---

<sup>2</sup><https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/4>

**2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Cilësia e performancës institucionale referuar ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik ka hapësirë për përmirësim veçanërisht në: divesifikimin e metodave të konsultimit publik; planifikimin e planit vjetor për konsultimin publik dhe respektimi i afateve nga ana e Drejtorive propozuese referuar këtij plani; përfshirjes sa më e madhe të sa më shumë aktorëve mbi marrjen e komenteve apo sugjerimeve të ndryshme.

Megjithatë, nga 5 projektaktet e publikuara nga MFE në Regjistrin Elektronik, 3 raporte individuale për rezultatet e konsultimit publik janë vlerësuar me pikët maksimale duke qënë kështu tregues se hartimi dhe publikimi i raporteve përkatëse individuale për rezultatet e konsultimit publik për secilin projekt akt të publikuar në Regjistër, kanë bërë transparente: kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike; metodat e konsultimit të përdorura; palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit, si edhe pasqyrën e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar apo refuzuara.

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, lidhen më së shumti me gjithëpërfshirjen e aktorëve në këtë proces. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të synojë që gjatë vitit 2022 të ketë përfshirje aktive të shumë aktorëve në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen duke kombinuar dhe përdorur disa metoda të procesit të konsultimit publik, si mundësia më e mirë për të arritur një rezultat efikas në të ardhmen. Gjithashtu vlerësohet se edhe angazhimi nëpërmjet rrjeteve sociale duke u realizuar edhe në kombinim me metodat e tjera të konsultimit publik do të sjellë rritje të përfshirjes dhe mundësive në këtë kuadër.